

D E K R E T
Nr.1588, datë 3.9.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPERISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8083, DATË 7.3.1996, NDRYSHUAR ME DEKRETIN NR.1511, DATË 29.6.1996

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Neni 3 i ligjit nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8083, datë 7.3.1996, ndryshuar me dekretin nr.1511, datë 29.6.1996, ndryshohet si vijon:

"Mallrat e veçanta që tatohen me akcizë dhe përqindjet e tyre janë:

Përqindja e akcizës

a) Duhan e prodhime duhani	
- cigare	50
- puro	70
- duhan për konsum	70
- letër cigare për shitje	50
b) Pije alkoolike	
- birrë	40
- verë	40
- raki	70
- konjak, uzo, fërnë, ponç, uiski, rum dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike të importuara	105
- likernat e importuara	85
c) Pije të buta e freskuese	
- vendi	5
- importi	30
ç) Ujë mineral dhe i gazuar	
- vendi-	
- importi	20
d) Kafe	30
dh) Alkool etilik prodhim vendi me fortësi 95.5 - 96%për prodhim pije alkoolike si uzo, fërnë, ponç, konjak, likerna, etj.	85
e) Alkool etilik prodhim vendi me fortësi 95.5 - 96% për prodhim pijesh alkoolike si uzo, fërnë, ponç, konjak, likerna, etj.	110
f) Alkool etilik rrushi (distilat vere) me fortësi 68 - 70% për prodhim pijesh alkoolike	80

Personave juridikë e fizikë vendas dhe të huaj, që prodhojnë për eksport pije alkoolike, vlera e akcizës së paguar në doganë ose në blerjet nga alkooli i prodhuar në vend u rimbursohet, për atë sasi alkooli të përdorur për prodhimin e pijeve alkoolike që eksportohen.

Përqindja akcizës

g) Nënproduktet e naftës	
- benzinë deri 75 oktan	
- vendi	15
- benzinë 75.1 - 89.9 oktan	
- vendi	47
- benzinë 89.9 oktan	

- importi	60
- benzinë 90 oktan e lart	
- importi	50
- gazoil	
- vendi	20
- importi	40
- valvolinë	80
- vajra lubrifikante të të gjitha llojeve dhe grasot	80
- të tjera (solar, mazut, koks nafte, bitum, gaz i lëngët, toluol, squfur, ksilol, solvent)	25

Importimi i çdo lloj nënprodukti nafte që nuk përfshihet në shkronjën “g”, përveç vajgurit, do të trajtohet me akcizë 300 për qind.

Përfshihen nga akcizat gazi i lëngët i importit për përdorim në popullsi, si dhe mazuti e solari të prodhuar në vend që përdoren për prodhim avulli për ngrohjen e popullsisë.

Për letrën e cigares, të importuar nga subjektet e ndryshme ekonomike që duhet për nevojat e prodhimit, të mos zbatohet akcizë në doganë.

Merret në formë akcize edhe diferenca ndërmjet çmimit përfundimtar të shitjes dhe çmimit të caktuar nga organet shtetërore, duke i shtuar këtij të fundit për nënproduktet e naftës përqindjet e caktuara në shkronjën “g” të këtij neni dhe taksën e qarkullimit rrugor për benzinën dhe gazoilin.

Për mallrat e përcaktuara në shkronjën “a”, kur importohen zbatohet një akcizë plus 35 për qind nga ajo e caktuar më lart, përjashtuar cigaret, për të cilat zbatohet një akcizë plus 50 për qind, dhe për ato të shkronjës “b” plus 25 për qind (ku përfshihen birra, vera dhe rakia).

Neni 2

Ligji nr.8083, datë 7.3.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7678, datë 3.3.1996 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.7797, datë 23. 2 .1994, ligjin nr.7821, datë 11. 5 .1994, ligjin nr.7901, datë 15.2 .1995 dhe ligjin nr.8029, datë 14.11.1995 dhe dekreti nr.1511, datë 29.6.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8083, datë 7.3.1996, shfuqizohen.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha